Numër: 01/557
Datë: 07.09.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 07.09.2022 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** me kusht institucioni Kolegji "Pjetër Budi", me adresë: Fushë Kosovë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 07.09.2022 deri më 06.09.2025, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - **1.1 Furrëtar,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 10 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në katër (4) grupe.
   - **1.1 Ndihmës Kuzhinier,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 10 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në katër (4) grupe.

2 Akreditimi dhe validimi i institucionit është aprovuar me kushtet si në vijim:

2.1. Akreditimi i institucioni vlen nën kushtet dhe zotimet e dhëna ekipit të eksperteve e të cilat janë pasqyruar edhe në raportin e akreditimit lidhur me plotësimin e kushteve sipas marrëveshjes me donatorin.

2.2. AKK do të organizoj një vizite shtesë me panelin e njëjtë te eksperteve vlerësues për të vërtetuar se objekti me të gjitha hapësirat ku do të ofrohet, vlerësohet dhe certifikohet kualifikimi a i plotëson kushtet sipas planifikimit të paraqitur me mbështetjen e projektit dhe me dosje të aplikimit, po ashtu pajisjet dhe të gjitha materialet tjera duhet të përmbushen sipas planifikimit të paraqitur me

mbështetjen e projektit dhe nevojat për ofrim, vlerësim dhe certifikim të kualifikimit.

2.3. Kolegjit "Pjetër Budit" nuk i lejohet të regjistroj kandidatët para se të plotësoj kushtet e vendosura për akreditim nga AKK.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit Kolegji "Pjetër Budi", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, shkresa e zotimit e datës 03.12.2021, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit Kolegji "Pjetër Budi", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK